



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 2818

Tirane, date 24.1.3./2015

Drejtuar: ZOTIT GAFURR PLOÇI
SHOQERIA "ALABADITA" SH.P.K
KOMUNA KRASTE MARTANESH, BULQIZE

DIBER

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr.387 date 08.01.1998.

I nderuar zoti Plloçi,

Shoqëria "Albadita" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.387 date 08.01.1998, për mineral kromi ne objektin "Lugu i Gjate, Dalja nr.7, (+1607 – sipërfaqe)" Bater, Bulqize , ne Qarkun Dibër.

Me urdhër te Ministrit te Energjisë dhe Industrisë nr. 329 date 22.10.2014 "Për kontrollin e realizimit te programit te zhvillimit për lejet minerare ne rajonin e Martaneshit, rrethi Bulqize, Qarku Dibër" është ngritur grupi i punës i përberë nga specialiste te Drejtorisë se Politikave dhe Zhvillimit te Minierave pranë kësaj ministrie, Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore, Repartit te Inspektim Shpëtimit te Minierave, i cili ka kryer kontrollin ne rajonin e përcaktuar ne Urdhrin ne fjale ne ditët e para te muajit nëntor te vitit 2014.

Pas kontrollit është hartuar raporti për secilën leje me propozimet përkatëse, ne zbatim te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar dhe akteve nënligjore qe kane dale ne zbatim te tij.

Grupi i Punës për lejen minerare nr.387 date 08.01.1998 qe zotërohet nga shoqëria "Albadita" shpk, ka propozuar te revokohet sepse:

"Subjekti nuk ka zbatuar kërkesat që burojnë nga Ligji Minerar Shqiptar Nr. 10 304, datë 15.07.2010 " Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", përkatësisht:

- ❖ Neni 47, pika 1, germa "c "zotëruesi i lejes minerare pezullon për 1 vit ose ndërpret veprimtarinë minerare, pa njoftuar më parë, jo më vonë se 90 ditë kalendarike, strukturat përgjegjëse të veprimtarisë minerare, duke përfshirë në njoftim dhe arsyet e këtij pezullimi ose ndalimi"; dhe
- ❖ Neni 47, pika 1, germa "ç " zotëruesi i lejes minerare, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e çdo viti në vazhdim, që i korrespondon datës së hyrjes në fuqi të lejes, nuk paraqet dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të planit të rehabilitimit, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të programit minimal të punës, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të investimit;

Leja juaj është dhënë me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" i ndryshuar, i cili është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve te tij edhe për lejet e dhëna përpara datës se hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr.387 date 08.01.1998, për mineral kromi ne objektin "Lugu i Gjate, Dalja nr.7, (+1607 – sipërfaqe)" Bater, Bulqize , ne Qarkun Dibër.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes nr.387 date 08.01.1998.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

